



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 24

Tiranë – E hënë, 18 gusht 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 10550, datë 11.8.2025	
Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, Tiranë.....	3



NJOFTIM

Nr. 10550, datë 11.8.2025

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS
SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË
INSTITUTIT TË PËRGATITJES SË
QENVE TË POLICISË, TIRANË**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, kapitulli III, shpallen për shitje me çmim fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, Tiranë

Nr.	Emërtimi	Datëlindja	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit në lekë	Zhvillimi i ankandit		
					Data	Ora	Vendi
1	Qeni Brandi	12.4.2014	Tiranë	10,000	2.9.2025	10:00	DSHPP
2	Qeni Sindi	15.11.2015	Tiranë	10,000	2.9.2025	10:15	DSHPP
3	Qeni Liza	1.11.2014	Tiranë	10,000	2.9.2025	10:30	DSHPP
4	Qeni Vreni	28.9.2018	Tiranë	10,000	2.9.2025	10:45	DSHPP
5	Qeni Mega	12.11.2014	Tiranë	10,000	2.9.2025	11:00	DSHPP

Çdo person fizik apo juridik, i interesuar për blerje, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerje e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

2. **Garancinë bankare apo mandatpagesën** në original, që vërteton ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë, për llogari të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për

vlerën e shpallur për shitje, i konfiskohet 20% e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand. Garancia bankare apo mandatpagesa duhet të bëhet detyrimsht brenda afatit të pranimi të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Garancia bankare apo mandatpagesa mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, pasi të keni tërhequr pranë DSHPP-së, ose degëve të thesarit në rrethe, faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit: www.meki.gov.al.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2025

